


Eja ta shohësh vetminë



Come and see loneliness





Lorik Sylejmani

Eja ta shohësh vetminë / Come and see loneliness

11.04.2018 - 12.05.2018

Katalogu - Catalogue:

Botues – publisher:

4 Galeria Kombëtare e Kosovës
National Gallery of Kosovo

Tekstet / texts:

Arta Agani, Labinot Kelmendi

Intervista / interview:

Rina Krasniqi

Fotografitë / Images:

Enver Bylykbashi

Përkthimi dhe lektura / Translation and proofreading:

Jehona Xhaferi

Dizajni / Design:

Trembelat

Shtypi / Print

VIPRINT

Viti / Year: 2018

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje nga Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve / The Exhibition And Catalogue Are Supported by the
Ministry of Culture, Youth and Sports:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo
MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Sponzorë Medial / Media Sponsors:



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës- National Gallery of Kosovo staff:
Arta Agani, Drejtoreshë -Director; Zeni Ballazhi, Kurator-Curator; Mexhide
Maxhuni, Zyrtare për financa -Finance officer; Lirije Buliqi, Zyrtare e lartë
administrative -Senior administrative officer; Naim Spahiu, Koordinator për
ekspozita -Coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi, Fotograf profesional
-Professional photographer; Skender Xhukolli, Teknik për ekspozita -Exhibition
technician; Rrahman Bislimi, Teknik për ekspozita/Mirëmbajtës i objektit
-Exhibition technician /Building caretaker; Xhevat Rrahimi, Kujdestar i sallës
ekspozuese -Exhibition hall attendant; Valdet Sylja & Mentor Abdullahu, roje nate
-security guards

Lorik Sylejmani

Eja ta shohësh vetminë/

Come and see loneliness





foto / photo: Atdhe Mulla

Artistët janë gjithnjë të
angazhuar për të shkruar
një histori të hollësishme
të së ardhmes sepse ata
janë të vetmit persona
që e njohin natyrën e së
tashmes

- Wyndham Lewis.

Artists are always
engaged to write a
detailed history of the
future because they are
the only persons who
know the nature of the
present

– Wyndham Lewis

Eja ta shohësh vetminë

... është ftesë për të hyrë në botën e Lorik Sylejmanit, mjeshtërisht të shfaqur para nesh në ekspozitën e tij vetanake me titull poetik. Titull ky, që nuk guxon të anashkalohet pa e marrë parasysh. Ne mund ta kuptojmë këtë titull në formë ftese, ose si një parashikim çuditërisht të errët të së ardhmes së njerëzimit, ose si një manifestim të vetmisë si një gjendje njerëzore jo domosdoshmërisht të keqe. Sido që ta kuptojmë, nuk do të gabojmë.

Ftesa e Lorikut i drejtohet kujtdo: si atyre që e njohin vetminë dhe vijnë për të kërkuar gjëra të përbashkëta, ashtu edhe atyre që nuk e ndiejnë vetminë, që të njihen me të dhe më pastaj të vendosin se a është vetmia tragjedi e njeriut bashkëkohor, apo ndoshta është interpretim melankolik i vetes.

Gjëja e parë që duhet marrë në konsideratë, që në mënyrë korrekte ta përjetojmë veprën e tij, është fakti se Sylejmani, duke na rikujtuar të kaluarën, e nominon vetminë si vetinë kryesore të njerëzimit sot, aq të rëndësishme sa të jetë thelbi i kësaj ekspozite. Pikturat por edhe veprat tjera të tij përmbajnë idhujt që i kishim dikur (Lou Reed në Dirty Blvd, Duchamp, Laurie Anderson, Laibach) dhe lojërat që luanim me amballazhe të lezetshme dhe ushqime të bukura (Bananet, Supa e Warholit) që na ndihmonin t'i ikim vetmisë. E vërteta është se, kjo është krejt çka ne dëshirojmë: të ikim nga vetmia. Çfarëdo që bëjmë, çdo ditë, çon kah kjo.

Megjithatë, Loriku na tërheq vërejtjen se nuk ka ikje, sepse jetojmë në një botë të çmendurisë digjitale dhe smart-phoneve, egoizmit të institucionalizuar dhe dashurisë ndaj vetes. Veprimet që bëjmë për t'i ikur ndjenjës së vetmisë, në fund rezultojnë me kthim të sërishëm tek vetmia, sepse ne jemi grupe individësh që ngadalë kthehen kah bota e brendshme e tyre.

E që, sipas artistit, nuk është bash fundi i botës.

Ai mëton të na tregojë një domethënie të re të vetmisë, dhe në sytë e tij, ajo nuk është një mallkim apo fatkeqësi e paralajmëruar. Është bekim në formë arti që hap vështirime të reja. Të jep mundësi të dëgjosh rrahjen e zemrës sate dhe të lexosh botën e qetësisë dhe simbolet e saja. Simbole këto, që materializohen në punën e Lorikut në formë tejet minimale, e që mund

t'i shohim qartë në veprën thelbësore të kësaj ekspozite, videon "Pse s'vjen ta shohësh vetminë".

Kjo prezencë qenësore dhe jo-figurative njerëzore zbërthehet në pjesëza më konkrete dhe realistike të ekspozitës. Edhe pse asnjëherë nuk i ik natyrës tejet private, pos paraqitjes së figurës së vetë artistit dhe pjesëtarëve të familjes së tij si ikona nostalgjike të vendosura strategjikisht, ai shpesh bën edhe digresione të imëta drejt botës së jashtme si element ndikues.

Patjetër duhet kuptuar gjeneratën e artistëve të cilës i takon Sylejmani, për të parë kombinimin e pazakonshëm të elementeve në ekspozitë, që variojnë prej amballazheve deri te reliktet e socializmit: ai i takon një gjenerate të cilën do ta quaja *Change-gen*, të cilës madje i kushtova një ekspozitë, Muzeu i Memories, 2015: "... pra muzeu jonë është një muze i artefakteve emocionale dhe sensuale, në një mënyrë është konceptualizim i kujtesës sonë. Ndryshime shoqërore, ekonomike, politike, lokale, globale, ndryshime sistemesh, qeverish, tranzicione prej një sistemi shoqëror në tjetrin, rishkrime të historisë, zhvendosje të dhunshme – krejt këto ndodhën gjatë jetës së kësaj gjenerate. Thënë shkurt, jemi një gjeneratë e tranzicionit në të gjitha aspektet e jetëve tona. Pastaj shtrohet pyetja: Çfarë ndikimi patën këto ndryshime në botën e një artisti? Për më tepër, a ishin këto ndryshime faktor esencial që formojnë një burim inspirimi për tu rishfaqur si formë arti me vlerë? Ne provuam të përgjigjemi në këto pyetje por njëkohësisht edhe të gjejmë ndërlidhjen mes krejt asaj që ne jemi sot, nën peshën e kujtesës kolektive."

Loriku dhe gjenerata e tij ishin fëmijët e parë Kosovar që provuan shijen hyjnore të Coca-Colas, dhe admiruan shishen e saj të bukur belhollë. Ishim ne të parët që iu ekspozuan çmendurisë reklamuese të të 80-tave, reklamave televizive dhe ngritjes së figurës së konsumatorit. Amballazhet e bukura konsideroheshin si relikte të një kohe të dominuar nga dizajni që së shpejti do ta mbizotëronte botën.

Artisti u tërhoq nga ky tundim i ëmbël dhe u bë dizajner. Ani pse në karrierën e tij, qartë e diferencon krijimtarinë artistike nga dizajni, ekziston ndikim i konsiderueshëm të cilin mund ta

shohim në veprat e tij të ndjeshme ndaj relacionit art-produkt, e që është një dilemë e përhershme për dizajnerët - se cila nga to është më e rëndësishme.

Deklarata e tij “Arti Imiton Jetën” është koment sarkastik ndaj artit që trajtohet si mall i dedikuar për shitje të suksesshme, me piktura skajshmërisht dekorative që përmbajnë imazhe të mallit tërheqës për konsumatorët, dhe ndonjëherë ngjyra vibruese në lojëra optike.

Edhe atëherë kur Loriku vë në pyetje ose komenton prezencën e tepruar në ikonave bashkëkohore dhe konsumerizmin, ai gjithmonë kthehet për t’iu kundervënë atyre me këndvështrimin e tij që përmban elementin e paevitueshëm të nostalgjisë. Qartë deklaron se ikonat janë ashtu siç ne dëshirojmë që të jenë ato, në veprën e tij 3M, ku Mona Lisa dhe Merilini janë të zhvendosura kah ikona më e rëndësishme për të: Nëna.

Po i njëjti element shfaqet te video “Rabini”, ku shkojmë në kohën kur videot muzikore ishin të rralla. Kënga e bendit të tij të preferuar Bankrot, “Rabini”, nuk kishte linjë vizuale. Dhe Loriku vendos që ta kombinojë atë me video amatore nga dasma e dajës së tij, incizuar përafërsisht në të njëjtën kohë. Në video paraqitet artisti si fëmijë i socializmit.

Ekspozita “Eja të shohësh vetminë” artisti përfundon duke tërhequr vëmendjen kah vetja si vëzhgues i pazëshëm i çmendurisë konsumatore dhe integritetit të komprometuar njerëzor, duke u distancuar nga to me një barrierë vetmie si faktor i refleksionit të thellë.

Arta Agani

... is an invitation to Lorik Sylejmani's world, masterfully shown to us in his solo exhibition with a poetic title. It is a title that mustn't be taken for granted and without consideration. We can either contemplate this title/invitation as an oddly obscure prediction of the future of humanity, or as a celebration of loneliness as a not-necessarily bad human condition. We would not be wrong in any case.

Lorik's invitation is addressed to everyone: those who know what loneliness is, to come and find common grounds; and to those that do not feel loneliness, to be introduced to it and then decide whether it is the tragedy of the contemporary human, or a melancholic interpretation of self.

First thing to be considered in order to correctly contemplate his work, is that by nostalgically reminding us of the past, he nominates loneliness as the main trait of today's human, important enough to be the core of this exhibition. His paintings contain images of idols that we used to have (Lou Reed in Dirty Blvd, Duchamp, Laurie Anderson, Laibach) and games we used to play with pretty packages and beautiful food (bananas, Warhol's soup) that helped us escape loneliness. Indeed, that is all we want: an escape from loneliness. All we do, every day, leads to that.

However, Lorik warns us that there is no escape from it because we live in a world of digital madness and smartphones, institutionalized egotism and self-love. Everything we do to escape from feeling lonely, finally results with loneliness after all because we are groups of individuals turning slowly towards our inner worlds.

Which is not the end of the world, after all, the artist says.

He wants to show us a new meaning of loneliness, and through his eyes loneliness is not a curse or a foretold disaster. It is a blessing in the form of art that opens new views. It gives you a possibility to hear your own heartbeat and read the world of silence and its signs. These signs are materialized in Lorik's work in a very minimal form, which we can see clearly in the core work of the exhibition, the video "Won't you come and see

loneliness.”

This essential non-figurative human presence breaks down to more concrete and realistic particles of the exhibition. Although it never escapes from being very private, in addition to images of the artist and his family members as strategically placed icons of nostalgia he also makes slight digressions toward the outside world as an influence.

One must understand the generation of artists that Sylejmani belongs to, in order to perceive the unusual combination of elements in the exhibition that range from packaging to socialism relics: he belongs to a generation I would like to address as the change –gen, to which I dedicated an exhibition concept -Museum of Memory, 2015: "...hence our museum is a museum of sensory and emotional artefacts - in a way, conceptualization of our memory. Social, economic, political, local, global changes, changes of systems, governments, transitions from one social system to another, rewritings of history, even forced settlement – all this happened during the lifetime of this generation. Simply, we are a generation of transition in all aspects of our lives. Then the question occurs: What impact have these changes had in the world of an artist? Moreover, were these changes and events an essential factor that would form a source of inspiration and would eventually manifest itself as a substantial art form? We tried to answer these questions and to find the connection of all that we are now, with the burden of collective memory.”

Lorik and his generation were the first Kosovo children to feel the glorious taste of Coca cola and admire its beautiful bottle with a waistline. We were one of the first that were exposed to advertising frenzy of the eighties, TV commercials and the rise of the consumer figure. Beautiful packages were considered relics of a design dominated era that was soon going to take over the world.

The artist got caught into this sweet temptation and became a designer. Although in his career he distinguishes his art career from design, there is considerable influence that we

can see in his works that are sensitive to the relation of art and product, which is also an everlasting dilemma for designers, as to which is more important.

His statement “Art Imitates Life”, is a sarcastic comment on art being treated as goods for market success, with excessively decorative paintings that contain consumer-luring goods, and at times, vibrant colours in optical games.

Even when he questions or comments the superfluous presence of contemporary icons and consumerism, he always comes back to oppose them with his own view with an inevitable element of nostalgia. It is obviously stated that icons are what we want them to be, in his 3M work, where Mona Lisa and Marilyn are turned deliberately to face his most important icon: Mother.

The same element shows up in the video “Rabini”, where we are brought back to the time when music videos were a rarity. His favourite band, Bankrot’s song, “Rabi”, had no visuals, so Lorik decided to combine it with an amateur video of his uncle’s wedding, taken approximately in the same period. The video shows the artist as a child of socialism.

In the “Come and see loneliness” exhibition, the artist ends up drawing attention to himself as a silent observer of consumer madness and compromised human integrity, distancing himself from it with a barrier of loneliness as a factor of deep reflection.

Arta Agani

Rastësisht në rrjetet sociale u takova me veprën e Lorikut. Gjëja që më befasoi në shikim të parë ishte inspirimi i tij nga kundërkultura e New York-ut dhe, në veçanti, emri provokativ i veprës “Endi, ky është Merlin Monro im”. Ndonëse bendet që dominonin shijet e mia vinin prej skenës së New York-ut, por, që të më atakonte sentimentin New York-ez në hapësirën artistike të Prishtinës ishte një shok për mua. Kështu, gjëja e parë që më erdhi në mendje ishte të njihesha me artistin, ta takoja punker-in me ironi angleze dhe shpejt u njoftova me të. Por, në këtë moment të shkrimit dua ta vras autorin që ta lind publikun (improvizim nga Roland Barthes, koncepti “Vdekja e Autorit”); publikun jo-të zgjedhur, e as kritik, por publikun i cili e ndjen veten pjesë të veprës për një moment; momentin që prodhon arti, si kodifikim i iracionalitetit njerëzor.

Nëse analizojmë veprën e Lorikut në planin estetik, vepra e tij është mjaft hibride, ajo shtrihet mes ekspresionizmit abstrakt dhe artit postmodern. Kjo është edhe pika e konfliktit që konceptualizon veprën e Lorikut, konflikti mes vetes dhe tjetrit. Nëse e vështrojmë veprën e tij, vetja na vjen si relativizëm postmodern, ku përditshmëria dhe momenti janë pjesë konstituive e veprës së tij. Ndërsa tjetri në aspekt të ekspresionizmit abstrakt që është revoltë kundër standardeve dhe shablloneve, si kthim kah thjeshtësia fëmijërore. Siç pohon E.M Gombriç në librin e tij Historia e Artit “... të gjithë besonin në nevojën për t’iu nënshtruar shtytjeve të brendshme spontane”.

Rastësia është nocioni adekuat që e përshkruan historinë e artit bashkëkohor, e kësaj gracke as vepra e Lorikut nuk mund t’i arratiset. Rastësia është nocioni i cili përshkruan realitetin e brendshëm dhe të jashtëm të veprës së Lorikut (atë që biologu francez Jacques Monod-i e përshkruan kështu: Njeriu e di që në fund është i vetmuar në pafundësinë mospërfillëse të gjithësisë prej së cilës ai ka dalë vetëm rastësisht); ku ngjyrat, intervenimet artistike, shpjegojnë në mënyrë elegante sharmin e hapësirës së vdekur industriale, të cilën Loriku mundohet ta ngjallë përmes kaosit të tij artistik. Kjo është ajo që kritiku amerikan Ray Bradbury e quan: vetëdije e re posthumaniste” (Citimi

është marr nga libri i Hans Bertens, “Koncepti i Postmodernes”, OM, Prishtinë, 2015). Ku nevoja për ta tejkaluar artin elitist modernist, prodhon gjendjen e re spontane që është vija lidhëse mes postmodernes dhe kundërkulturës (Hans Bertens).

Vet Loriku e konceptualizon artin e tij si harmoni totale të tingujve që shkrihen në ngjyra dhe prodhon një hapësirë të re urbane. Hapësirë në të cilën nuk mund të komunikohet përmes gjuhës sepse është e mangët për shpjegimin e realitetit kompleks. Hapësira e re urbane që, njëkohësisht, është niveli më i lartë i komunikimit dhe përmes refleksionit krijon stimulimin e ri inter-komunikativ.

Reciklimi i Përditshmërisë

Ripërpunimi i lëndëve të papërpunuara është njëra ndër format e artit bashkëkohor, ku artisti me një teknikë të hollë intervenon në sendin e gatshëm (Marcel Duchamp, Roy Lichtenstein, Jasper Johns, etj). Këto teknika janë influencë e veprës së Lorikut, i cili përmes kreativitetit që posedon transponon realitetin dhe përditshmërinë e tij në vepër arti.

Në veprën “Endi, ky është Merlin Monro im”, Loriku përmes ngjyrave dëshiron ta riciklojë përditshmërinë si revoltë ndaj jetës monotone. Aty shihen lëndë të papërpunuara sikurse kanaqja e cila njëherazi tregon agjentin kryesor të veprës - përditshmërinë. Momenti është shumë i rëndësishëm në këtë vepër e cila dekodohet përmes një meta-gjuhe (gjuhët programuese të cilat paralajmërojnë botën kibernetike). Kjo influencë në vepër është nga bendi gjerman Kraftwerk i cili përmes muzikës elektronike projekton një distopi robotike. Në fakt edhe vetë vepra e Lorikut, në këtë rast përmes një mprehtësie provokuese, e prodhon një distopi (Huxley, Orwell, Bradbury). Përditshmëria që e jetojmë riciklohet përmes një realiteti fiktiv, i cili, duke mos qenë utopik, është distopi që shfaqet si revoltë ndaj autonomisë së ekskluzivitetit. ...që rebelohet kundër koncepteve tradicionale, “humaniste” të natyrës dhe funksionimit të artit (Hans Ber-

tens, Koncepti i Postmodernes, OM, Prishtinë, 2015). Riciklimi i realiteti është momenti posthumanist i përditshmërisë distopike që përbën këtë vepër.

Arti postmodern në këtë vepër ngjason me konceptimin e kritikes amerikane Susan Sontag, e cila artin postmodern e përkufizon kështu: Arti postmodern thjesht është dhe duhet të jetë i përjetuar. Arti modernist i referohet një kuptimi të fshehur prapa sipërfaqes së tij. Arti postmodern e prezanton veten si sipërfaqe. Kjo vepër në mënyrë shumë të natyrshme përfaqëson veten pa ngarkesën e kuptimit si një esencë e cila i jep vlerë asaj. Kjo vepër i largohet gjykimit të vlerësimit dhe kuptimësisë, sepse ajo përfaqëson veten dhe nuk ka nevojë për interpretim. Në formën eksplicite të saj, ajo paraqet anti-artin, ose anti-intelektualin. Pjesa konstituive e veprës është përditshmëria, e cila konkretisht shpreh edhe relativizmin, gjakftohësin e subjektit brenda kësaj vepre karshi infeksionit ideologjik.

Vepra “Cyberportrait” është një portret i cili në mënyrë eksplicite e delegjtitmon konceptin romantik të portretit dhe të bukurës, këtu është edhe mjeshtëria ironike dhe sentiment i anti-artit, si revoltë ndaj formave të etabluara si vlera në art. Kjo vepër në mënyrë vulgare e shpërfaq konceptin e bukurisë kibernetike si eksplozion i brendësisë. Ku hapësira përshkruan shkrirjen e teknologjisë me art (Susan Sontag), dhe kjo shkrirje e ri-prodhon një ndijim të ri, që i nënshtrohet një hapësire të re komunikuese e cila është më e drejtpërdrejtë dhe më aktive. Atë që Marshal McLuhan pohon se: Në çdo fushë, qoftë kjo shkencë apo e dijeve humane, artisti është ai që kupton implikimet e veprimeve të veta dhe të shkencës së kohës ku jeton. Artisti është njeriu me vetëdije integrale”

Punk, JO Pop Art

Muzika është pjesë integrale e veprës së Lorikut. Bendet si: Velvet Underground, Laurie Anderson, Bauhaus, Laibach janë tinguj minimalistë që pësojnë metamorfozë në veprën e tij. Veprat

titullohen sipas emërimit të këngës ose bendit, gjë që tregon se çfarë ndikimi ka muzika në artin e tij. Format të cilat paraqiten në këto vepra si sipërfaqe kanë atë që mund ta quajmë: ekspresionizëm abstrakt i një imagjinate konkrete. Format eksplicite që Loriku ka zgjedhur ta përshkruaj muzikalitetin e brendshëm, bën që këtë pjesë të artit të tij ta kuptosh vetëm përmes muzikës Punk.

Vepra “O Superman” është inspiruar nga kënga e Laurie Anderson, kjo vepër në mënyrë abstrakte e përshkruan botën e konsumit masiv. Coca-Cola dhe topi i bejsbollit janë elementet me të zakonshme në shoqërinë perëndimore, ato që janë *trademark* i shoqërisë së konsumit, që gjithashtu janë sinonim i kësaj. Kjo vepër përfaqëson revoltën ndaj kësaj dhe shoqërisë së konsumit, njëherazi ky është refuzimi artistik, që si background të vetin e ka punkun si liri e përjetimit të brendshëm. Coca-Cola në këtë vepër ka ngjyrën e kaltër, si improvizim rebelues ndaj riprodhimit masiv. Një vepër tjetër që në mënyrë shumë spontane tregon karakterin rebelues të punk kulturës në veprën e Lorikut është vepra “Walk on the Wild Side” e inspiruar nga kënga me po të njëjtin e emër e bendit eksperimental amerikan Velvet Underground të cilët e kishin ikonën e Pop art-it, Andy Warhol, si producent të tyre. Kjo vepër paraqet subjekte të cilat rebelohen ndaj realitetit, ose ajo që njihet në studimet e pop-kulturës si: degeneration (degjenerim), që përmes muzikës mundoheshin të arratiseshin nga normat që kornizonin konceptimin mbi shoqërinë.

Vepra “Boogie Woogie - PRN-LND-PRN” është arratisja nga trashëgimia e surrelizmit, nga koncepti i “pikturës së kulluar”, katrorët që nuk janë në harmoni të plotë, e që paralajmërojnë atë klithmën që E.H Gombrich e quan: “shkaravina foshnjore të periudhës para se fëmijët fillojnë të sajojnë figura”- kjo është e madhështia e thjeshtësisë së kësaj vepre, e cila është model i ekspresionizmit abstrakt që përmes formave të thjeshta rrëfen gjendje komplekse. Ky lloj i pikturimit është trashëgimi e artit të lindjes, më saktësisht artit kinez që ndikoi Amerikën e film viteve të 50-ta (Jackson Pollock, Franz Kline, etj). Vepra

tjetër “Duet Neoni” me motivacion ekspresionizmin abstrakt, përmes ngjyrës së gjelbër paraqet thjeshtësinë e para-gjuhës, e e gjithë kjo harmonizohet me vijat që përshkruajnë fëmijën tek Zarathustra që është burimi i kreativitetit.

Përfundimi

Konceptualizimi i kësaj pjese të artit përfundon në heshtjen e pangarkuar të fëmijës, qenie e cila nuk i nënshtrohet asnjë konvencioni shoqëror. Vepra e Lorikut është udhëtim në pafundësinë që konkretizohet në imagjinatën e një të çmenduri, sepse vetëm të çmendurit mund të fluturojnë lirshëm.

Labinot Kelmendi, filozof

I encountered by chance Lorik's work in social media. What surprised me the most at first glance was his inspiration from New York's counter-culture and especially the provocative title of his work "Andy, he is my Marilyn Monroe". Although, my taste is dominated by bands coming from New York scene, I was shocked to be attacked by the New York sentiment in Prishtina artistic space. Thus, the first thing that came to my mind was to get to know the artist, to meet the punker with British irony; and soon I met him. However, at this point of writing I want to kill the author to give birth to the audience (improvised from Roland Barthes, the concept "The death of the Author"); the non-selected audience, nor critique, but the audience which feels as part of the work for a moment; the moment which is produced by art, as a codification of human irrationality.

If we analyse Lorik's work from an aesthetic level, his work is quite hybrid, it extends between abstract expressionism and post-modern art. This is also the point of conflict which conceptualizes Lorik's work, conflict between oneself and the other. If we observe his work, oneself comes as post-modern relativism, where daily life and the moment are constitutive parts of his work. While, the other as an aspect of abstract expressionism which is the revolt against standards and patterns, as a return towards childlike simplicity. As E.M Gombrich states in his book *Art History* "... everybody believed in the need to submit to inner spontaneous impulses".

Coincidence is the adequate notion which describes the history of contemporary art, and even Lorik's work cannot escape from this trap. Coincidence is the notion which describes the inner and outer reality of Lorik's work (the one that French biologist Jacques Monod describes as: Human knows that in the end he is lonely in the indifferent vastness of universe where from he emerged only coincidentally); where colour, artistic interventions, elegantly explain the charm of dead industrial space, which Lorik tries to revive through his artistic chaos. This is what American critic Ray Bradbury calls: new posthuman consciousness" (The quote is taken from the book of Hans

Bertens, "The Idea of Postmodern" OM, Prishtina, 2015). When the need to overcome modern elitist art produces the new spontaneous condition which is the link between postmodern and counterculture (Hans Bertens).

Lorik himself conceptualizes his art as total harmony of sounds merging in colours and produces a new urban space. A space where one can't communicate through language because it is deficient for explaining the complex reality. The new urban space which is the highest level of communication and at the same time creates the new inter-communicative stimulation through reflection.

Recycling the Daily Life

Reprocessing the unprocessed material is one of contemporary art forms, where artist with a fine technique intervenes in a readymade item (Marcel Duchamp, Roy Lichtenstein, Jasper Johns, etc.). These techniques are the influence of Lorik's work, who transposes his reality and daily life in art work with the creativity he possesses.

In the work "Andy, he is my Marilyn Monroe", Lorik wants to recycle the daily life through colours as a revolt towards monotonous life. There you can see unprocessed material like tin can which at the same time shows the main agent of the work – daily life. The moment is of high importance in this work which is decoded through meta-language (programming languages warning the cyber world), the influence in this work is from the German band Kraftwerk, which projects a robotic dystopia through electronic music. In fact, even Lorik's work in this case, produces a dystopia through a provoking sharpness (Huxley, Orwell, Bradbury). The daily life we live is recycled through a fictional reality, which, being non-utopian is a dystopia expressed as a revolt against the autonomy of exclusivity. ... that rebels against traditional, "humanist" concepts, of art's nature and function (Hans Bertens, The idea of postmodern, OM, Prishtina, 2015). Recy-

cling the reality is the post-humanist moment of dystopic daily life that comprises this work.

Postmodern art in this work resembles the concept of American critic Susan Sontag, who defines postmodern art as: Postmodern art is simple and should be experienced. Modern art refers to a hidden meaning in its surface. Postmodern art presents itself in the surface. This work represents itself in a very natural way and without the burden of understanding as an essence which gives value to it. This work distances from the judgment of evaluation and meaning, because it represents itself and does not need interpretation. In its explicit way, it expresses anti-art, or anti-intellectual. The constitutive part of the work is daily life, which namely expresses also the relativism, the equanimity of the subject within this work as opposed to the ideological infection.

The work "Cyber portrait" is a portrait which explicitly delegitimises the romantic concept of portrait and beauty, here is present also the ironic mastery and the anti-art sentiment, as a revolt against established forms as value in art. This work reveals the concept of cyber beauty in a vulgar manner as an inner explosion. Where space describes the merging of technology with art (Susan Sontag), and this merging re-produces a new feeling that submits to a new communication space which is even more direct and active. This is what Marshal McLuhan states: In every field, be it science or human knowledge, the artist is the one who understands the implications of his actions and of science of the time he lives in. Artist is the human with integral consciousness"

Punk, NOT Pop Art

Music is an integral part of Lorik's work. Bands like: Velvet Underground, Laurie Anderson, Bauhaus, Laibach are minimalist sounds that undergo metamorphosis in his art. His works are titled according to a name of a song or a band, which shows the

influence music has in his art. Forms that are shown in these art works have in their surface what we may call: abstract expressionism of a real imagination. Explicit forms which Lorik has chosen to describe the inner musicality, makes it possible to understand this part of his art only through Punk music.

The art work “O Superman” is inspired from the song of Laurie Anderson; this art work describes the world of massive consumption in an abstract manner. Coca-Cola and the baseball are the most common elements in the western society, they are the trademark of the consumption society, which is also the synonym of kitsch. This art work represents the revolt against kitsch and the consumption society, and at the same time is an artistic rejection, which as its background has punk as a freedom of inner experience. Coca-Cola in this art work is of blue colour as a rebellious improvisation against massive reproduction. Another art work which shows the rebellious character of punk culture in a very spontaneous manner in Lorik’s works is the art work “Walk on the Wild Side” inspired by the song with the same title from the American experimental band Velvet Underground, whose producer was the Pop-art icon, Andy Warhol. This art work presents subject rebelling against the reality, or what is known in pop-culture studies as: degeneration, where they were trying to escape from the norms framing the concept of society through music.

The art work “Boogie Woogie – PRN-LND-PRN” is an escape from the surrealism heritage, from the concept of “pure painting”, squares which are not in full harmony, and which foretell the cry that E.H Gombrich calls: childlike scrabble form the period before children start to compose figures” – this is the greatness of simplicity in this art work, which is the model of abstract expressionism that tells about the complex situation through simple forms. This kind of painting is the inheritance from eastern art, namely Chinese art which influenced the American movies of 50s (Jackson Pollock, Franz Kline, etc.). The other art work “Duet Neoni” (Neon Duet) with abstract expressionism as motive, through green colour represents the

simplicity of pre-language, and all this is harmonised with lines describing the child in Zarathustra, which is the source of creativity.

Conclusion

Conceptualizing this part of art ends with the unburdened silence of a child, a being that doesn't submit to any social convention. Lorik's art work is a journey in the vastness materialized in the imagination of a lunatic, because only lunatics can fly freely.

Labinot Kelmendi, philosopher

Rina Krasniqi

Lorik Sylejmani ka banuar në lagjen Ulpiana, në Prishtinë gjatë gjithë jetës, i rrethuar me banesat e hirëta të arkitekturës socialiste, që sipas tij e karakterizojnë qytetin e Prishtinës dhe i japin atij sharm. I lindur në vitin 1972, Sylejmani është artist vizuel që në punën e tij flet për kulturën urbane dhe tema të tjera sociale dhe përdorë medime të ndryshme të shprehjes si piktura, dizajni grafik, instalacioni dhe videoarti.

Ai ligjëron histori të dizajnit dhe brendit dhe udhëheq emisionin e tij autorial PilotUnderground në radio, ku flet për muzikën, që është një aspekt i rëndësishëm në punën e tij si artist.

Veprat e tij janë shfaqur në ekspozita të shumta ndërkombëtare si së fundmi në Imago Mundi – Benetton Collection, Qendra Kulturore në Sarajevë (2017), SCOPE Miami (2015), Exposure, Pavilion Richelieu, Louvre Museum në Paris (2014) etj.

Tani, për njëzet vjetorin e karrierës së tij artistike, ai do të shfaqet në Galerinë Kombëtare të Kosovës me një ekspozitë retrospektive të quajtur “Come and see loneliness! / Eja ta shohësh vetminë!” ku ai e fton publikun që ta kërkojnë një pjesë të vetmisë në veten e tyre.

RK: Është e qartë që muzika ka një rol shumë të rëndësishëm në punën tënde. Ke qenë edhe pjesë e një bendi që është quajtur Strofollogu i Gugutkës. Më trego për referencat e tua muzikore, prej kur ke filluar të mireshe me muzikë dhe me punk apo me lifestyle'in punk – nëse mund me themi kështu.

LS: Gjatë fundviteve të 80-a dhe fillim të 90-ave, me Gëzim Krasniqin – Majorkën, Besim Lutollin – Becin dhe me Tomorr Gjinovcin – Belbën kishim formu një bend që quhej Strofollogu i Gugutkës. Bënim punk. Në të vërtetë këta të tre kanë pasur një bend më herët dhe këngët e tyre ishin pak a shumë rock. Kur u futa në bend dhe filluam të bënim prova për koncerte bashkë, arrita ta ndryshoj qasjen. Të gjitha ato këngë i ktheva në punk. Bile kishim një këngë veç me një rresht tekst

dhe një rresht refren. Rreshti ishte: Aga Haki, djali i ri; ndërsa refreni ishte: Vëllau i Ramës! Kaq. Kemi qenë bendi i parë punk shqiptar! Diku në një kasetë i kemi të inçizuar si demo versione tetë këngë, si dhe dy përpunimet e këngëve: I'm waiting for the man nga Velvet Underground, Disorder nga Joy Division si dhe Zarjavele Trobente nga Lacni Franz.

RK: Me çka preokupoheshin Strofollogu i Gugutkës? Çfarë ishin brengat, apo nga çfarë zemëroheshit?

LS: Ne thjeshtë donim të bënim muzikë për vete, dhe ndoshta për një rreth të ngushtë. Disa nga tekstet e bendit tonë ishin veçse të shkruara para se të bashkangjitesha unë. Të gjitha qenë tregime personale por jo domosdoshmërisht përcaktuese për një kohë. Aga Haki, Nata, Rrospija, Inxhja, 44 shkallë, dhe Pantollat lara-lara ishin disa nga këngët e bendit, dhe mendoj se është mëkat që nuk janë inçizuar zyrtarisht edhe pse duke u bazuar në përvojat e bendeve tjera, nuk besoj që do lejohej të publikoheshin për shkak të censurës. Paramendojeni! Në fund të viteve të 80-ta në Kosovë të dëgjohej një këngë me këtë tekst:

‘E mjera ti e mjera
gaqicat vjerr te dera
taksirat une e pata
s’fjeta sa ke nata
Oj rrospi’

ose

“Mos inxhe mos
më nguc
mos inxhe se jom
tuc”

RK: Muzika apo arti konceptual arrijnë me tërënjë më shumë vëmendje për çështjet sociale? Cili medium është më i fuqishëm?

LS: Mendoj se muzika është një medium shumë i fuqishëm me të cilën mund të thuash shumë, por jo edhe ta ndryshosh botën, kjo s’ka ndodhë së paku gjer më sot! Artet në përgjithësi janë në një linjë me njëra tjetrën, dhe besoj që kanë një ndikim deri diku të njëjtë.

RK: Çfarë muzike ke dëgjuar duke u rritur?

LS: Jam rritur në një familje ku është dëgjuar muzikë e mirë, nga të gjitha zhanret. Prindërit e mi kanë dëgju rock, pop, shansona, muzikë të lehtë qytetare, ato burimore shqiptare, opera etj. Derisa njëri prind ka dëgjuar Bee Gees, tjetri i ka pasur për zemër Betales. Apo derisa njëri Elvisin e Charles Aznavurin, tjetri Chuck Berryn dhe Stonsat e deri te vendorët Dervish Shaqa, Riza Blaca, Liri Rasha, Tefta, Sabri Fejzullahu, Liliana Qavollin e shumë e shumë të tjerë. Natyrisht, s’kisha nga ja mbaja. Edhe unë u dashurova në muziken e këtyre muzicientëve që nga shkolla fillore.

RK: Cila ka qenë LP e parë që e ke blerë, dhe cili bend ka pasur më së shumti ndikim në formimin tënd?

LS: Për herë të parë në moshë shumë të re e kam blerë LP Blondie and the Hunters. Albumin e pata blerë në një shitore ku shiteshin kaseta, LP-ja, dhe instrumente muzikore, - ai dyqan gjindej përfundi hotel Grand-it në Prishtinë. Ishte një ndër pikat më të preferuara të mia në qytet të cilën e vizitoja shumë shpesh.

E bendi që ma ka ndryshuar komplet pikëpamjen për jetën dhe filozofinë e të menduarit e jetuarit ka qenë produkti machesterian Joy Division. Kam qenë në vitin e parë të shkollës së mesme. Ia dhash një shokut të klasës një kasetë të zbraztë dhe duke e ditur se kishte një fqinj që posedonte në koleksionin e vet qindra albume bendesh, i thash se do doja shumë të më bënte ai inçizimin e cilit do album të Siouxsie and the Banshees. Kaseta ishte 90 minutshe. Kur ma solli shoku kaseten isha tejet i lumtur ta dëgjoja Siouxien, mirëpo ajo më e bukura ishte se fqinji i shokut tim si “dhuratë”, ma kishte inçizuar edhe një bend tjetër, në anën B të kasetës shkruhej Joy Division. Mund ta paramendosh se sa i hutuar kam qenë dhe sa i çuditur kur e kam ndëgjuar për herë të parë atë kasetë. Aty më është këputur komplet filmi! Më asgjë nuk ishte e njetë! Disa muaj më vonë nga po i njëjti njeri e kisha blerë albumin e bendit Gang of

Four. E pata grithur pllakën e gramafonit duke e dëgjuar nga 50 herë në ditë këngën Paralyse, të cilën e dëgjoj edhe tash kohë paskohë. Disa vite më vonë u njoha me Velvet Underground dhe krijimtarinë e Warhol-it. Prej vitit të katërt të shkollës së mesme prapë përjetoj një shok kulturor kur dëgjoj këngën O Superman të Laure Andersonit, ndërsa po të njetin vit, si dhuratë më kishte bërë nëna ime dy kaseta të bendit Laibach me albumet Simpathy for the Devil dhe Let It be që ishte përpunim industrial i albumit të lengjendarve The Betales dhe kjo si duket ishte një moment nostalgjie i nënës sime, pasi që në mesin e viteve 60', ajo kishte qenë në koncert të The Betales në Londër ose Birmingham - as asaj si kujtohej më saktë ku.

RK: Pos dyqanit ndër Grand, cilat ishin pikat tjera të preferuara për ty në qytet në atë kohë?

LS: Unë dhe Gëzimi (Majorka) tentonim të sillnim frymën underground përmes projekteve tona artistike që shumica nga to kanë ndodhur në shupën e shtëpisë së tij, një vend që më ka frymëzuar shumë, kjo shtëpi gjindej në lagjen e Kacallarëve. Fatkeqësisht ajo më nuk ekziston, në atë hapësirë është ndërtuar një objekt shumëkatësh, dhe me të ka ikë gjithashtu një pjesë shumë e rëndësishme e një fryme më off qe jemi munduar ta sjellim në qytet. Në kohën time gjithashtu ka qenë Kurrizi si hapësirë ku secili kishte mundësinë të gjejë kafiterinë e tij të preferuar.

RK:Me jakne të lëkurës, xhinse dhe maica të bendeve që i përmende në rrugët e Prishtinës në fundvitet e 80' dhe vitet e 90', a ka qenë vështirë në atë kohë të jesh punker në Prishtinë?

LS: Dua të jem i sinqertë: Punk skena nuk ka ekzistuar kurrë në Prishtinë! Kemi qenë ne si bend Strofologu i Gugut-kave dhe vite më vonë bendi KEK. Me kaq përfundon çdo gjë sa i përket punkut në këtë qytet. Mund të ketë patur pas luftës ndonjë tentativë, por nuk e di. Ndërsa new wave e rryma të tjera ka pasur. Gjurmët me ca këngë, Vivien, Ëndrrat Moderne dhe Bankrot që më shumë kanë qenë Ol Punk.





Gëzim Krasniqi / Majorka, 2000

Prishtina në atë kohë ka qenë një qytet që po rritej dhe ndikimet muzikore vinin direkt nga MTV. Sot, thridhjetë vite më pas, kur dëgjoj ndonjë këngë nga ajo kohë, e që atëherë i quanim me shaka “limunada”e kuptoj ndikimin latent të MTV-së pasi që shpesh e zë vetën duke i kënduar shumicën e këngëve përmendësh. E din atë këngën Video killed the radio star, kjo është pikërisht çfarë MTV-ja bëri.

E tash, të themi shoqëria jonë kanë qenë 50% adhures të pop-it dhe 50% adhures të këngës burimore shqipe, mund ta paramendosh sa ke qenë i pranuar si punker në shoqëri, aq më tepër nëse ke dashur ta përvetësosh imazhin e punkut për të cilën po flet ti. Më kujtohet kur i lyva flokët me ngjyrë të kuqe.

RK: Pse të kuqe?

LS: Nuk e di, mbase ka qenë e vetmja që e kam gjetur në shtëpi! Ka qenë diku viti 1988, të gjithë më shikonin çuditshëm kur ecja nëpër qytet, edhe pse Violeta Regjepagiqi i kishte thyer disa tabu në lidhje me këto gjëra më herët, mirëpo une isha mashkull, dhe flokët e kuqe ishin shumë të pazakonta në një shoqëri socialiste siç kemi qenë atëherë, e kuqja ishte e rezervuar për diçka tjetër, për një klasë tjetër. Por, edhe ata individë që kanë dëgju punk, e kanë qenë pak, janë dukur shumë normal në imazh, bile shumica prej tyre kanë qenë student të elektros! A mund ta paramendosh?

RK: Të rinjët mund të njohin nga Radio, ti ke një emision që quhet PilotUnderground në Radio Kosova 2. Çfarë muzike lëshon më dëshirë sot dhe pse ke vendosë me punu pikërisht në radio?

LS: Si fëmijë shtrihesha para tranzistorit, apo edhe para kasetofonit dhe e shikoja pandërprerë. Prisja ti zija tinëzishte ata njërezit e vegjël që janë futur në atë kuti. Isha i bindur se aty rrijnë e punojnë njerëz të vegjël si nëpër përralla. Gjithashtu influencë kishin edhe tregimet e babait se si kishte dëgjuar çdo

